

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“BIO ITALIA” SHPK**



**Neni 1**

**Forma e shoqërisë dhe ortaku themelues**

- 1.1 Shoqëria themelohet nga ortaku themelues si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.
- 1.2 Ortaku themelues i shoqërisë do të jetë: **Z. Alfonso Tramontano, shtetas italian, i biri Pasquales dhe Imatolates, i datelindjes 31.08.1962 lindur e banues ne Sant 'Antonio Abbate(Na) i pasaportes italiane nr.YA6627446 , madhor me zotësi të plotë për të vepruar.**

**Neni 2**

**Emërtimi**

- 2.1 Shoqëria emërtohet **“BIO ITALIA ” shpk**

**Neni3**

**Baza ligjore**

- 3.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me nenet e këtij Akt Themelimi, statutit, Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” si dhe me dispozitat e tjera në fuqi të legjislacionit shqipëtar.

**Neni 4**

**Objekti i veprimtarisë**

- 4.1 **Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë:**

Import-eksport,tregeti me shumice e pakice mallra te ndryshme industriale bujqesore dhe blektorale,ushqimore si dhe materiale te ndertimit.

Import – eksport, tregeti me shumice e pakice, te reja ose te perdorura , makineri ,fabrika , kombine industriale, bujqesore,blektorale etj. Import – eksport, tregtim me shumice e pakice, te reja ose te perdorura , te pjeseve te kembimit per makinerite, fabrikat, kombinatet etj qe sherbejne ne cdo fushe te tregtise se lejuar .

Import eksport te karburanteve, etj.

Prodhim, perpunim,ruatje, transportim, shperndarje si dhe te tregtim i produkte bujqesore dhe blegtorale ne gjendjen e tyre natyrore ose te perpunuara me pare.

Grumbullim fruta - perime. Tregti me pakice dhe shumice te tyre. Import - eksport.

Prodhim, perpunim,ruatje, transportim, shperndarje si dhe te tregtim i produkteve te ambalazhit ne material qelqi,druri, karton etj.

Studime, projektme, zbatime konculenca ne fushen e industrise bujqesore dhe ne ngrtijen e plantacioneve me te gjitha llojet e frutave e perimeve.Mbjellje shtim perpunim e shfrytezim i te gjitha llojeve te frutave e perimeve.

Prodhimi i të gjitha nenprodukteve si lengje , salce, tul, etj qe perfitohen nga fruta perimet pas perpunimit te tyre . Import-Eksport, tregeti me shumice e pakice te:te te gjitha farerave te fruta perimeve; te te gjithë fidanave te fruta perimeve; te ilaçeve qe luftojne semundjet e fruta perimeve; lengjë të ndryshme fruta perimesh; te makinerive dhe te gjithë aksesoreve qe perdoren per prodhimin e lengjeve me fruta prodhime; si dhe te gjithë artikujve qe lejohen me ligj.

Zhvillimin e strukturave me funksion prodhues te mbeshtetura nga programe kombetare apo nderkombetare investimesh, prodhimi, perpunimi dhe distribuimi i produkteve bujqesore e blektorale te ndryshme.

Menaxhimi, blerja , marrja dhe dhënia me qira, ndërtimi, si dhe shitja e pasurive të paluajtshme. Menaxhimi i bizneseve te ndryshem si bar kafe,restorante, pasticeri, markete ,supermarkete, etj Megjithate shoqeria ka te drejte qe te shtoje objektin e veprimtarise se saj me vendim te ortakut si dhe shoqeria mund te marre persiper perfaqesime, te hape agjensi te ngre filiale ne te gjithë vendin.

Prodhimi, vetë ose në bashkëpunim me persona të tjerë, të produkteve ushqimore dhe jo-ushqimore me destinacion rishitjen brenda vendit si dhe /ose për eksportim.

Megjithate shoqeria ka te drejte qe te shtoje objektin e veprimtarise se saj me vendim te ortakut si dhe shoqeria mund te marre persiper perfaqesime, te hape agjensi te ngre filiale ne te gjithë vendin

Të gjitha veprimtaritë e përshkruara më sipër mund të zhvillohen si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.

Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çfarëdolloj veprimtarie tjetër të lejuar nga ligji dhe në përputhje me rregullat në fuqi.

- 4.2 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet, të kufizohet ose të zgjerohet në bazë të vendimit të Asambles së ortakëve.
- 4.3 Për të realizuar qëllimet e saj Shoqëria mund të sigurojë dhe të përdorë financime nga ortakët, nga vende të tjera ose nga institucione financiare vendase ose të huaja.

#### **Neni 5 Selia e shoqërisë**

- 5.1 Shoqeria e ka seline ne Tirane , Rr. Muhamet Gjollësha , Pall.19, Shkalla e pare, Ap.10.
- 5.2 Shoqëria me vendim të Asambles së ortakëve, ka të drejtë të hapë degë dhe zyra përfaqësimi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë saj.

#### **Neni 6 Kohëzgjatja**

- 6.1 Shoqëria do ta ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar.
- 6.2 Asambleja e ortakëve mund të vendojë për mbylljen e menjëhershme të aktivitetit të Shoqërisë ose kufizimin e afatit të kohëzgjatjes së saj.



## Neni 7 Kapitali i Shoqërisë

- 7.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është **100 Leke (nëqind leke)** i përbërë nga 1 (një) kuote me vlerë nominale 100 leke (nëqind leke) e zotëruar nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë **Z. Alfonso Tramontano**.
- 7.2 Kapitali i shoqërisë do të nënshkruhet dhe shlyhet nga ortaku themelues **Z. Alfonso Tramontano** dhe ky kapital përfaqëson 100% të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

## Neni 8 Administrimi

- 8.1 Shoqëria do të administrohet vetëm nga një administrator. Asambleja e ortakëve vendos nëse administrimi i shoqërisë do të bëhet nga një apo disa administratorë, të cilët në rastin e fundit nuk mund të jenë më pak se 2 (dy) dhe më shumë se 5 (pesë).
- 8.2 Administrimi i Shoqërisë konsiston në kryerjen e të gjithë veprimeve të administrimit për realizimin e objektit të veprimtarisë së Shoqërisë.  
Me themelimin e Shoqërisë emërohet si Administratori i parë:  
**Z. Besnik Shamblli, i biri Petraqit dhe Anastasise, i datelindjes 07.04.1951, lindur në Korce, e banues në Tiranë Rr. Perlat Rexhepi, Pallati Jeshil Nr.12, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i letërnjoftimit elektronik me Nr.028265233 dhe Nr. Personal F104070911.**
- 8.3 Administratori i vetëm ose administratorët qëndrojnë në detyrë për 3 vjet, përveç rasteve kur shkarkohen me vendim të Asamblesë së ortakëve. Administratori mban përgjegjësi personale përball shoqërisë dhe të tretëve për shkelje të mundshme të ligjit dhe/ose Statutit apo për gabime të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
- 8.4 Në rastin kur Shoqëria zgjedh disa administratorë, administratorët mund të veprojnë bashkërisht dhe/ose veç e veç. Megjithatë, nëse ekzistojnë mosmarrëveshje ndërmjet administratorëve, këto i adresohen Asamblesë së Ortakëve.
- 8.5 Administratori/administratorët mund të shkarkohen në çdo kohë me vendim të Asamblesë së ortakëve, me votën e ortakëve që zotërojnë më shumë se gjysmën e kapitalit themeltar. Ortakët nuk janë të detyruar të motivojnë vendimin e tyre.
- 8.6 Në rastin e shkarkimit të administratorit, Asambleja e ortakëve duhet të thirret brenda 30 (tridhjetë) ditëve për emërimin e administratorit të ri, në rast se ky vendim nuk është marrë në të njëjtën mbledhje Asambleje kur është vendosur shkarkimi.

## Neni 9 Viti financiar

- 9.1 Viti financiar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, dhe fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti.
- 9.2 Si përjashtim, viti i parë financiar do të fillojë në datën e regjistrimit të shoqërisë pranë organeve kompetente dhe do të përfundojë më 31 Dhjetor 2017.

## Neni 10 Të ardhurat, Dividentët

- 10.1 Fitimet që rezultojnë nga mbyllja e vitit financiar, pas pagimit të tatimeve dhe detyrimeve të tjera ligjore që shoqëria ka ndaj të tretëve, mund të ndahen ndërmjet ortakëve në përpjesëtim më pjesët që ato zotërojnë në kapitalin themeltar.
- 19.1 Humbjet e shoqërisë do të mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe çdo ortak do të përgjigjet deri në kufirin e kontributit të tij në kapitalin themeltar të Shoqërisë.

**Neni 11**  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

11.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së Shoqërisë, zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt kompetencë ekskluzive për zgjidhjen e tyre do të kenë gjykatat shqiptare.

**NENI 12**  
**Dispozita perfundimtare**


Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe perkthyer ne gjuhen Italiane nga perkthyesja **Arta Mezini ,mbajtese e leternjoftimit elektronik m e Nr.031083418 dhe Nr.Personal H25503109M ,dhe** u miratua nen per nen nga Ortaku themelues i shoqerise tregtare **"BIO ITALIA "** SHPK, nenshkruset ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale.

Ky Akt Themelimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **"BIO ITALIA"** sh.p.k hartohet në 4 (katër) kopje autentike në gjuhën shqipe, secila me të njëjtën vlerë ligjore.

Autorizohet **Z.Besnik Shamblli** te depozitoje kete akt themelimi prane Qendres Kombetare te Biznesit.


**ORTAKU THEMELUES**

**Alfonso Tramontano**



Tirane me 22.02.2017

**Perkthyes**  
**Arta Mezini**

*ARTA MEZINI*  




REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 485 Rep.

Nr. — Kol.

VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Tirane, sot me date 22/2/.2017 perpara meje notere Marsela Veseli , Anetare e Dhomes se Noterise Tirane, u paraqit personalisht: **Alfonso Tramontano, shtetas italian, datelindjes 31.08.1962 Lindur e banues ne Sant 'Antonio Abbate(Na) mbajtes i pasaportes italiane nr.YA6627446 , madhor me zotësi të plotë për të vepruar** , i cili me cilesine e Ortakut Themelues te Shoqerise " **BIO ITALIA** " SHPK, ka nënshkruar Aktin e Themelimit dhe Statutin e mesiperm, duke shkruar emrin mbiemrin dhe firmen e tyre orgjinale ne kete zyre para meje Noterit  
Une Noterja vertetoj rregullsine dhe bazueshmerine e redaktimit ne ligj të ketij akti si dhe autenticitetin e nenshkrimeve, me cilesine qe me njeh neni 55 i Ligjit nr. 7829, date 01.06.1994. "  
Per Noterin " ne Republiken e Shqiperise.

NOTERE  
Marsela VESELI